UDHËZIM
Nr.580, datë 15.8.2006

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR.114, DATË 1.11.2005 "PËR SHOQËRITË ANONIME "NË LIKUIDIM E SIPËR" ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR"

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", seksioni i V "Likuidimi", ligji nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

UDHËZON:

Në "Udhëzimin" nr.114, datë 1.11.2005 "Për shoqëritë anonime "Në likuidim e sipër" me kapital tërësisht shtetëror", në fund të paragrafit të parë të pikës 5, shtohet paragrafi si më poshtë:

"Bëjnë përjashtim metalet me ngjyra si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaj, nikeli, ari dhe argjendi. Vlera fillestre e ankandit për këto metale, për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, do të llogaritet duke iu referuar çmimit të bursës së Londrës (LME). Në rast se nuk realizohet shitja me vlerën e llogaritur sipas LME-së, shoqëria cakton vlera të tjera deri në vlerën kontabël të mallit".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli